



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR K R Y E T A R I

Rr."28 Nëntori", Shkodër – Shqipëri, Tel: 355 2224 28 73; www.qarkushkoder.gov.al; qarkushkoder@yahoo.com

Nr.592 Prot.

Shkodër më 02 / 06 / 2017

Kërkesë për shprehje interesi

Specialist për Menaxhimin e Projektit “Blue Net” - Maritime Clusters Network for Blue Growth “BlueNet”, Thirrja EASME/EMFF/2015/1.2.1.7

Në kuadër të zbatimit të projektit “Blue NET” - *Maritime Clusters Network for Blue Growth “BlueNet”, Thirrja EASME/EMFF/2015/1.2.1.7*, Këshilli i Qarkut Shkodër shpall konkursin për pozicionin **Specialist për Menaxhimin e Projektit** me kohë të pjesshme (Part Time).

Projekti “Blue NET” - *Maritime Clusters Network for Blue Growth “BlueNet”,* përfshin gjashtë partnerë nga pesë vende evropiane: Italia, Bullgaria, Kroacia, Qiproja dhe Rumania dhe 1 partner (kandidat për në BE), Shqipërinë.

Pjesëmarrja në këtë projekt është e rëndësishme dhe lidhet ngusht me implementimin e Strategjisë së BE-së për Rajonin Adriatiko-Jonian. Nëpërmjet këtij Projekti synohet mbështetja dhe zhvillimi i strukturave detare nëpërmjet ndarjes së praktikave më të mira ndërmjet partnerëve, një projekt shumë i vlefshëm jo vetëm për Qarkun Shkodër, por edhe në nivel kombëtar, në funksion të ndarjes së eksperiencave më të mira të vendeve evropiane.

Projekti bashkon vende dhe zona me nivele të ndryshme ndryshme, për sa i përket ekspertizës dhe **know-how** në zhvillimin dhe implementimin e grupimeve/clusters detare, të përcaktuara si "grupe gjeografikisht të përafërta" të kompanive të ndërlidhura dhe institucioneve që kanë lidhje me fushën detare, institucione që lidhen nga të përbashkëtat që ato kanë.

Pjesëmarrja në këtë projekt është e rëndësishme dhe lidhet ngusht me implementimin e Strategjisë së BE-së për Rajonin Adriatiko-Jonian, nga ku rezultate të pritshme janë:

- Mbështetja dhe zhvillimi i strukturave detare nëpërmjet praktikave më të mira dhe mësimëve të nxjerra.
- Vlerësimi i situatës aktuale të grupimeve detare në vend/rajon; vlerësimi i situatës për sa i përket teknologjisë; mjeteve inovative; aftësive dhe kompetencave në sektorin detar.

- Ndarje dhe krahasimi i rezultateve mes partnerëve në mënyrë që të identifikohen nevojat për të zgjedhur praktikat më të mira për përgatitjen e mjeteve të përbashkëta të ndërhyrjes.
- Rritja e bashkëpunimit dhe nxitja e konkurrencës tek territoret e përfshira
- Organizimi i eventeve për ndarjen e praktikave më të mira në mënyrë që të identifikohen iniciativa të përbashkëta për zhvillimin e politikave të përbashkëta në fushën e inovacionit teknologjik dhe rritjen e konkurrencës.

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

1. Ushtron përgjegjësitë e zbatimit të projektit, duke kryer të gjitha përgjegjësitë e menaxhimit të projektit.
2. Përgatit Raportet Analitike apo Financiare, hedh të dhënat në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit –në kuadër të aktiviteteve të këtij projekti.
3. Përgatit dokumentacionin mbështetës financiar dhe interesohet për çertifikimin e shpenzimeve.
4. Bashkëpunon me Stafin e Këshillit të Qarkut Shkodër , mbi realizimin e aktiviteteve të projektit.
5. Bashkëpunon me stafin e projektit për realizimin e procedurave të prokurimit në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e PRAGUT të BE-së.
6. Ndjek dhe koordinon punën me institucionet përkatëse, në lidhje me raportimet financiare.
7. Ndjek dhe koordinon punën, në lidhje me raportimet të partnerëve të përfshirë në këtë projekt.
8. Administron të gjithë dokumentacionin e projektit dhe i arkivon ato.

Të interesuarit duhet të dorëzojnë në Këshillin e Qarkut Shkodër, brenda datës 23 / 06 / 2017, një kopje të dokumentacionit të mëposhtëm

- Diplomë universitare . Ka përparësi eksperti/specialisti që është i diplomuar jashtë vendit.
- Të ketë jo më pak se tre vite eksperiencë profesionale në fushën e projekteve ndërkombëtare.
- Të ketë kualifikime të veçanta në fushën profesionale, ka përparësi eksperti që ka kryer kualifikime dhe trajnime jashtë vendit.
- Të jetë njohës shumë i mirë i gjuhës angleze.
- Të ketë njohuri shumë të mira në kompjuter.

Kandidati i suksesshëm do të punësohet me kohë të pjesshme. Detyrat dhe përgjegjësitë e tij, do të përcaktohen me kontratë.

APLIKIMI

Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentacionin në zarf të mbyllur jotransparent, deri me datë **23 /06 /2017, ora 10:00** (Adresa: *Rruga 28 Nëntori, Shkodër*). Mbi zarf duhet shënuar pozicioni për të cilin aplikoni, emri, nënshkrimi dhe adresa e kandidatit konkurrues, si dhe emërtimi i dokumentacionit që përmban zarfi. Përveç dokumentacionit të kërkuar (CV¹, kopje të diplomës/certifikatave) duhet të dorëzohet edhe letër interesi, e cila përmend pozicionin për të cilin aplikon kandidati, si dhe një listë të dokumenteve bashkangjitur kërkesës.

Kërkesa për shprehje interesi do të qëndrojë e hapur për 15 ditë **zyrtare pune**, në web-in e Këshillit të Qarkut Shkodër: www.qarkushkoder.gov.al

K R Y E T A R I

Greta BARDELI

¹ Tek CV, duhet të shënohet përveç të tjerash email-i i personit të interesuar dhe numri i kontaktit.